# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-398694**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Begaj pret ambasadoren e re të Zvicrës: Forcim i marrëdhënieve dhe rritje e investimeve zvicerane në Shqipëri – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/begaj-pret-ambasadoren-e-re-te-zvicres-forcim-i-marredhenieve-dhe-rritje-e-investimeve-zvicerane-ne-shqiperi/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 00:18:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 3 shtator 2026, 10:47:10 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c7b13b0ccc0ae0e651a86effd976147f0f18807f057f21e8d215c7c873b264f2` |
| TEKSTI | `3c7e2c95459422e55a15e48c66a17f6297c389453df9004faac46aa926a497db` |
| PAMJA | `4882296891e950fd1ed69b5470ba07bf21b35b14799d310d3b7266a0802ba633` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4e010faddebb01003cb188c20921353200854a8e200dc48e4ad35c2918239234` |
| E MËPARSHMJA | `e07c4899e49469c4477e9401ab1b1f5de1a2499cbd7320660869a1d595ee0d4d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4e010faddebb01003cb188c20921353200854a8e200dc48e4ad35c2918239234`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Ilustrim · Vizion Plus

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, priti në një takim Ambasadoren e re të Konfederatës Zvicerane në Shqipëri, Sh.S. Dr. Siri Walt, me rastin e prezantimit të Letrave Kredenciale.

Presidenti Begaj i përcolli Ambasadores Walt urimet më të mira për fillimin e detyrës së saj në Shqipëri dhe shprehu besimin se mandati i saj do t'i shërbejë forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera mes dy vendeve.

Gjatë takimit u vlerësuan marrëdhëniet e ngushta dhe miqësore Shqipëri–Zvicër, të mbështetura në vlera të përbashkëta evropiane, dialogun e rregullt politik dhe një bashkëpunim të gjerë në fusha me rëndësi të veçantë, përfshirë qeverisjen, zhvillimin ekonomik, arsimin dhe formimin profesional, shëndetësinë, qeverisjen vendore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Presidenti Begaj shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Zvicrës në proceset e zhvillimit demokratik, ekonomik dhe social të Shqipërisë, si dhe për kontributin e saj në forcimin e institucioneve dhe qeverisjes vendore përmes programeve të bashkëpunimit për zhvillim dhe asistencës teknike.

Kreu i Shtetit çmoi në mënyrë të veçantë investimet e qeverisë zvicerane në zonat rurale.Ne kemi njerëz dhe një natyre të mrekullueshme, – u shpreh ai.Investimet në këto zona në rritjen e cilësisë së jetesës janë një investim që bëjmë për brezat e rinj. Gjithashtu, ruajta e trendit pozitiv që

5 Viti i ri shkollor nis edhe në burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin…

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Shqipëria ka në turizëm ndihmohet shumë nga këto investime", – u shpreh Presidenti i Republikës.

Presidenti Begaj theksoi rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe mirëpriti rritjen e investimeve dhe praninë e shtuar të bizneseve zvicerane në Shqipëri.

Në takim u vlerësua  roli i rëndësishëm i Diasporës shqiptare në Zvicër, si një urë e fortë lidhëse mes dy vendeve dhe popujve.

#Ambasadore #BEgaj #Zvicer

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



POLITIKË

**Reforma territoriale, Mazniku në Vizion...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:41



POLITIKË

**Dita e 107-të e protestës, qytetarët...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:41



POLITIKË

**Rama niset drejt Italisë, do të marrë...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 21:52

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.